



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË  
LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 26.02.2020)*

**Pika 1 e rendit të ditës me objekt:** Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave: 27.12.2019; 30.12.2019; 09.01.2020; 14.01.2020; 21.01.2020; 29.01.2020; 30.01.2020; dhe 06.02.2020.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:35 dhe mbaroi në orën 15:17.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 5. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 6. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 7. Elisa Stamo, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 8. Anisa Brano, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 9. Gentiana Bigu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 10. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 11. Anisa Kuqi, EURALIUS.*
- 12. Tahir Lamçe, OSCE.*
- 13. Përfaqësues të medias.*

**RENDI I DITËS:**

1, Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave: 27.12.2019; 30.12.2019; 09.01.2020; 14.01.2020; 21.01.2020; 29.01.2020; 30.01.2020; dhe 06.02.2020.

Mbledhja plenare e datës 26 shkurt 2020 fillon me fjalën hyrëse të Kryetares së Këshillit, zonjës Naureda Llagami e cila shprehet se në këtë mbledhje plenare, Këshilli i Lartë Gjyqësor do të trajtojë disa projekt-akte të rëndësishme të cilat shënojnë një hap përpara drejt funksionalizimit të Gjykatës së Lartë dhe fuqizimit të Gjykatave të Posaçme

për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, duke ecur kështu përpara me vendosjen e rregullave të cilat hapin praktika të qëndrueshme, transparente dhe që garantojnë standarde drejtësie dhe paanshmëri në të gjitha proceset. Këto projekt-akte të cilat do trajtohen sot në këtë mbledhje janë një punë e konsultuar si brenda Komisionit dhe Këshillit por edhe të konsultuara hap pas hapi me misionet ndërkombëtare që asistojnë Këshillin.

Zonja Llagami shton në fjalën e saj se, sot dhe nesër Këshilli do të përfundojë vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatëve për në Gjykatën e Lartë që vijnë nga radhët e juristëve të spikatur dhe më pas duke e dërguar listën për emërim pranë Presidentit të Republikës së Shqipërisë. Sot Këshilli hap rrugën e promovimit gjyqtarëve profesionistë dhe me integritet për në Gjykatën e Lartë dhe në Gjykatat e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Ky promovim do të bëjë të mundur rifreskimin në këto gjykata të cilat hasin nevoja të thella si dhe do të vitalizohen me gjyqtarë karriere, me figurë të pastër dhe përvojë profesionale të konsoliduar.

Kështu, Këshilli është pranë realizimit të objektivave thelbësor të tij, pranë garantimit të një drejtësie cilësore dhe të besueshme për qytetarët.

*(Pas fjalës hyrëse të Kryetares, ftohen kameramanët të largohen nga salla e mbledhjes dhe gazetarët të ulen në ambientet e sallës së mbledhjes për të ndjekur vijimin e mbledhjes plenare.)*

Fillon çështja e parë e rendit të ditës e cila është:

“Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave: 27.12.2019; 30.12.2019; 09.01.2020; 14.01.2020; 21.01.2020; 29.01.2020; 30.01.2020; dhe 06.02.2020”.

Anëtarët e Këshillit për këtë çështje të rendit të ditës nuk kanë diskutime, prandaj çështja hidhet në votim nga Kryetarja e Këshillit dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është dakord.

Dritan Hallunaj është dakord, me përjashtim të procesverbalit të datës 30.12.2019 (në të cilin nuk ka marrë pjesë në mbledhje).

Illir Toska është dakord.

Alban Toro është dakord.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është dakord, me përjashtim të procesverbaleve të datave 27.12.2019 dhe 30.12.2019 (në të cilat nuk ka marrë pjesë në mbledhjet plenare).

Medi Bici është dakord.

Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim Këshilli i Lartë Gjyqësor, vendosi:

“1. Miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave 27.12.2019; 30.12.2019; 09.01.2020; 14.01.2020; 21.01.2020; 29.01.2020; 30.01.2020 dhe 06.02.2020.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi dhe publikimin e këtyre procesverbaleve Kryetarja e Këshillit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.”

\* \* \*

(Pika 1 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË  
LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 26.02.2020)*

**Pika 2 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i 6 projektvendimeve për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për 6 pozicione të lira përkatësisht: 3 në fushën e të drejtës administrative; 3 në fushën e të drejtës civile.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:35 dhe mbaroi në orën 15:17.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)

*10. Erjon Muharremaj* (anëtar)

*11. Marçela Shehu* (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 5. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 6. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 7. Elisa Stamo, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 8. Anisa Brano, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 9. Gentiana Bigu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 10. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 11. Anisa Kuçi, EURALIUS.*
- 12. Tahir Lamçe, OSCE.*

#### **RENDI I DITËS:**

2. Shqyrtimi i 6 projektvendimeve për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për 6 pozicione të lira përkatësisht: 3 në fushën e të drejtës administrative; 3 në fushën e të drejtës civile.

Relator i kësaj çështjeje është zoti Ilir Toska.

Merr fjalën zoti Ilir Toska i cili lexon relacionin shpjegues nr. 1428 prot., datë 25.02.2020, lidhur me përmbajtjen e 6 projektvendimeve për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për 6 pozicione të lira

përkatësisht: 3 në fushën e së drejtës administrative dhe 3 në fushën e së drejtës civile.

Ndër të tjera në relacion i propozohet mbledhjes plenare:

- Hapja e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për 3 pozicione të lirë në fushën e së drejtës administrative dhe 3 pozicione të lirë në fushën e së drejtës civile dhe shpallja e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve që plotësojnë kriteret ligjore për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë.

- Afati i kandidimit të jetë 2 javë (për pozicionin e parë), 2 muaj (për pozicionin e dytë) dhe 5 muaj (për pozicionin e tretë) nga dita e publikimit të këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

### **Diskutime/Komente/Pyetje/Propozime mbi çështjen**

Pas leximit të relacionit nga ana e zotit Toska, merr fjalën zoti **Maksim Qoku** i cili vlerëson analizën e thellë që i është bërë shkaqeve dhe që nuk ka pikëpyetje apo diskutime rreth çështjes në fjalë.

Pas fjalës së zotit Qoku, merr fjalën zoti **Medi Bici** i cili është i mendimit se duhet të hapen 14 vendet e Gjykatës së Lartë dhe jo vetëm 6 vende, pasi gjyqtarët mund të merren nga ato gjykata që nuk prishin punë, duke plotësuar kriteret mbi 13 vjet gjyqtar apeli, etj. Ndërsa sa i përket gjyqtarëve të Gjykatës së Krimeve të Rënda (sot Gjykata e Posaçme), ai është i mendimit se ata janë gjyqtarët më të paguar të Republikës së Shqipërisë dhe nuk mund të quhet promovim kalimi i tyre në Gjykatën e Lartë, kur ata i bie të marrin 60% të pagës më pak.

Zoti Bici i referohet gjithashtu dy dekreteve të Presidentit të Republikës (vitet 2007 dhe 2010) ku është emëruar Prokurorja e Përgjithshme, si dhe një gjyqtar i Gjykatës së Apelit të Krimeve të Rënda që është emëruar në Gjykatën e Lartë, por shton se gjyqtarët e krimeve të rënda nuk janë promovuar asnjëherë, as nga ish-KLD.

Gjithashtu zoti Bici i kujton Këshillit ngritjen e Komisionit të Posaçëm për stokun e çështjeve (35.000 të tilla) në Gjykatën e Lartë. Ai ngre pyetjen, - Si do të bëhen gati këto çështje kur atje nuk ka gjyqtarë?

Pas diskutimeve të tij, zoti Bici propozon që në Gjykatën e Lartë të hapen 14 vende vakante.

Pas fjalës së zotit Bici, e merr fjalën zonja **Brunilda Kadi** e cila shprehet se edhe ajo i ka pasur shqetësim një pjesë të diskutimeve të zotit Bici, por relacioni i ka dhënë përgjigje pjesës më të madhe të shqetësimeve që ajo kishte. Të vetmen pikë që zonja Kadi ka merak dhe që nuk gjen përgjigje tek relacioni, është hapja e 14 vendeve vakante përkundrejt detyrimit ligjor (nenit 48/6 të ligjit për Statusin) si dhe mosplotësimi i të gjitha vendeve në Gjykatën e Lartë do të pengonte plotësimin e Gjykatës Kushtetuese, 1/3 e së cilës zgjidhet nëpërmjet Gjykatës së Lartë dhe pa u plotësuar trupa e Gjykatës së Lartë, teorikisht dhe praktikisht nuk mund të plotësohet Gjykata Kushtetuese. Zonja Kadi shton faktin që argumentet e paraqitura në relacion qëndrojnë të gjitha dhe prandaj për momentin ajo është pro propozimit të Komisionit për hapjen e këtyre 6 vendeve, me arsyetimin që në një moment të dytë, mund të rikonsiderohet situata dhe të hapen vendet e tjera.

Pas diskutimeve të zotit Bici dhe zonjës Kadi, merr fjalën zoti **Ilir Toska** i cili sqaron se pasi të shihen indikacionet që do dalin nga dy procedurat e para të ngritjes në detyrë, mund të shpallet një procedurë tjetër për ngritjen në detyrë. Pra sipas tij Gjykata e Lartë të plotësohet në mënyrë graduale dhe të bëhet funksionale brenda të njëjtës periudhë kohore që do duhej të bëhej edhe po të shpallnin të 14 vendet vakante njëherësh.

Pas diskutimeve nga disa nga anëtarët e Këshillit, Kryetarja e Këshillit hedh në votim propozimin e bërë nga zoti Bici për hapjen e 14 vendeve vakante në Gjykatën e Lartë dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është kundër.

Brunilda Kadi është kundër.

Dritan Hallunaj është kundër.

Ilir Toska është kundër.

Alban Toro është kundër.

Fatmira Luli është kundër.

Marçela Shehu është kundër.

Erjon Muharremaj është kundër.

Brikena Ukperaj është kundër.



Medi Bici është pro.

Naureda Llagami është kundër.

*(10 anëtarë janë kundër propozimit të zotit Bici. Rrëzohet propozimi i zotit Bici për hapjen e 14 vendeve vakante në Gjykatën e Lartë.)*

Hidhet më pas në votim propozimi i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është dakord.

Dritan Hallunaj është dakord.

Iilir Toska është dakord.

Alban Toro është dakord.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është dakord.

Medi Bici është kundër.

Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim Këshilli i Lartë Gjyqësor, sipas propozimit të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, vendosi miratimin e 6 projektvendimeve si më poshtë:

“Miratimin e projektvendimit “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për një pozicion të lirë në fushën e së drejtës administrative”.

“Miratimin e projektvendimit “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për një pozicion të lirë në fushën e së drejtës administrative”.

“Miratimin e projektvendimit “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për një pozicion të lirë në fushën e së drejtës administrative”.

“Miratimin e projektvendimit “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për një pozicion të lirë në fushën e së drejtës civile”.

“Miratimin e projektvendimit “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për një pozicion të lirë në fushën e së drejtës civile”.

“Miratimin e projektvendimit “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për një pozicion të lirë në fushën e së drejtës civile”.

\* \* \*

(Pika 2 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË  
LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 26.02.2020)*

**Pika 3 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i 5 projektvendimeve për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për 5 pozicione të lira.

*Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.*

*Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:35 dhe mbaroi në orën 15:17.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. **Naureda Llagami** (kryetare)
2. **Maksim Qoku** (zëvendëskryetar)
3. **Medi Bici** (anëtar)
4. **Fatmira Luli** (anëtare)
5. **Brunilda Kadi** (anëtare)
6. **Dritan Hallunaj** (anëtar)
7. **Illir Toska** (anëtar)
8. **Alban Toro** (anëtar)
9. **Brikena Ukperaj** (anëtar)
10. **Erjon Muharremaj** (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 5. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 6. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 7. Elisa Stamo, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 8. Anisa Brano, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 9. Gentiana Bigu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 10. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 11. Anisa Kuqi, EURALIUS.*
- 12. Tahir Lamçe, OSCE.*

**RENDI I DITËS:**

3. Shqyrtimi i 5 projektvendimeve për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për 5 pozicione të lira.

Relator i kësaj çështjeje është zoti Ilir Toska.

Merr fjalën zoti Ilir Toska i cili lexon relacionin shpjegues nr. 1429 prot., datë 25.02.2020, lidhur me përmbajtjen e 5 projektvendimeve për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e

Organizuar, për 5 pozicione të lira.

Ndër të tjera në relacion i propozohet mbledhjes plenare:

- Hapja e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për 5 pozicione të lira dhe shpallja e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve që plotësojnë kriteret ligjore për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

- Afati i kandidimit të jetë 2 javë (për pozicionin e parë), 4 javë (për pozicionin e dytë), 6 javë (për pozicionin e tretë), 8 javë (për pozicionin e katërt) dhe 10 javë (për pozicionin e pestë) nga dita e publikimit të këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Anëtarët e Këshillit për këtë çështje të rendit të ditës nuk kanë diskutime, prandaj hidhet në votim nga Kryetarja e Këshillit propozimi i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës mbi projektvendimin e parë “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për 1 pozicion të lirë”, ku afati i kandidimit është dy javë nga dita e publikimit të këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është dakord.

Dritan Hallunaj është dakord.

Illir Toska është dakord.

Alban Toro është dakord.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është dakord.

Medi Bici është dakord.

Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim Këshilli i Lartë Gjyqësor, sipas propozimit të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, vendosi miratimin e projektvendimit “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për 1 pozicion të lirë” (afati i kandidimit është dy javë).

Hidhet në votim nga Kryetarja e Këshillit propozimi i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës mbi projektvendimin e dytë “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për 1 pozicion të lirë”, ku afati i kandidimit është katër javë nga dita e publikimit të këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është dakord.

Dritan Hallunaj është dakord.

Iilir Toska është dakord.

Alban Toro është dakord.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është dakord.

Medi Bici është dakord.

Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim Këshilli i Lartë Gjyqësor, sipas propozimit të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, vendosi miratimin e projektvendimit “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për 1 pozicion të lirë” (afati i kandidimit është katër javë).

Hidhet në votim nga Kryetarja e Këshillit propozimi i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës mbi projektvendimin e tretë “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në

Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për 1 pozicion të lirë”, ku afati i kandidimit është gjashtë javë nga dita e publikimit të këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është dakord.

Dritan Hallunaj është dakord.

Ilir Toska është dakord.

Alban Toro është dakord.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është dakord.

Medi Bici është dakord.

Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim Këshilli i Lartë Gjyqësor, sipas propozimit të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, vendosi miratimin e projektvendimit “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për 1 pozicion të lirë” (afati i kandidimit është gjashtë javë).

Hidhet në votim nga Kryetarja e Këshillit propozimi i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës mbi projektvendimin e katërt “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për 1 pozicion të lirë”, ku afati i kandidimit është tetë javë nga dita e publikimit të këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është dakord.

Dritan Hallunaj është dakord.

Irir Toska është dakord.  
Alban Toro është dakord.  
Fatmira Luli është dakord.  
Marçela Shehu është dakord.  
Erjon Muharremaj është dakord.  
Brikena Ukperaj është dakord.  
Medi Bici është dakord.  
Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim Këshilli i Lartë Gjyqësor, sipas propozimit të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, vendosi miratimin e projektvendimit “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për 1 pozicion të lirë” (afati i kandidimit është tetë javë).

Hidhet në votim nga Kryetarja e Këshillit propozimi i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës mbi projektvendimin e pestë “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për 1 pozicion të lirë”, ku afati i kandidimit është dhjetë javë nga dita e publikimit të këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.  
Brunilda Kadi është dakord.  
Dritan Hallunaj është dakord.  
Irir Toska është dakord.  
Alban Toro është dakord.  
Fatmira Luli është dakord.  
Marçela Shehu është dakord.  
Erjon Muharremaj është dakord.  
Brikena Ukperaj është dakord.  
Medi Bici është dakord.



Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim Këshilli i Lartë Gjyqësor, sipas propozimit të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, vendosi miratimin e projektvendimit “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për 1 pozicion të lirë” (afati i kandidimit është dhjetë javë).

\* \* \*

(Pika 3 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË  
LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 26.02.2020)*

**Pika 4 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i 5 projektvendimeve për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për 5 pozicione të lira.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:35 dhe mbaroi në orën 15:17.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 5. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 6. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 7. Elisa Stamo, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 8. Anisa Brano, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 9. Gentiana Bigu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 10. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 11. Anisa Kuqi, EURALIUS.*
- 12. Tahir Lamçe, OSCE.*

#### **RENDI I DITËS:**

4. Shqyrtimi i 5 projektvendimeve për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për 5 pozicione të lira.

Relator i kësaj çështjeje është zoti Ilir Toska.

Merr fjalën zoti Ilir Toska i cili lexon pjesë nga relacioni shpjegues nr. 1430 prot., datë 25.02.2020, lidhur me përmbajtjen e 5 projektvendimeve për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për 5 pozicione të lira. Arsyetimi është i njëjtë ashtu si edhe për

Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ku veçantia është vetëm tek kriteri i përvojës profesionale, që në këtë rast është i ndryshëm, konkretisht kandidatët për në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar duhet të kenë ushtruar funksionet jo më pak se 7 vjet si gjyqtarë, nga të cilat 5 vjet të paktën në fushën e drejtësisë kriminale, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar.

Ndër të tjera në relacion i propozohet mbledhjes plenare:

- Hapja e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për 5 pozicione të lira dhe shpallja e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve që plotësojnë kriteret ligjore për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

- Afati i kandidimit të jetë 2 javë (për pozicionin e parë), 4 javë (për pozicionin e dytë), 6 javë (për pozicionin e tretë), 8 javë (për pozicionin e katërt) dhe 10 javë (për pozicionin e pestë) nga dita e publikimit të këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Anëtarët e Këshillit për këtë çështje të rendit të ditës nuk kanë diskutime, prandaj hidhet në votim nga Kryetarja e Këshillit propozimi i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës mbi projektvendimin e parë “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për 1 pozicion të lirë”, ku afati i kandidimit është dy javë nga dita e publikimit të këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është dakord.

Dritan Hallunaj është dakord.

Illir Toska është dakord.

Alban Toro është dakord.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është dakord.

Medi Bici është dakord.

Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim Këshilli i Lartë Gjyqësor, sipas propozimit të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, vendosi miratimin e projektvendimit “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për 1 pozicion të lirë” (afati i kandidimit është dy javë).

Hidhet në votim nga Kryetarja e Këshillit propozimi i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës mbi projektvendimin e dytë “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për 1 pozicion të lirë”, ku afati i kandidimit është katër javë nga dita e publikimit të këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është dakord.

Dritan Hallunaj është dakord.

Illir Toska është dakord.

Alban Toro është dakord.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është dakord.

Medi Bici është dakord.

Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim Këshilli i Lartë Gjyqësor, sipas propozimit të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, vendosi miratimin e projektvendimit “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe

Krimin e Organizuar, për 1 pozicion të lirë” (afati i kandidimit është katër javë).

Hidhet në votim nga Kryetarja e Këshillit propozimi i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës mbi projektvendimin e tretë “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për 1 pozicion të lirë”, ku afati i kandidimit është gjashtë javë nga dita e publikimit të këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është dakord.

Dritan Hallunaj është dakord.

Illir Toska është dakord.

Alban Toro është dakord.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është dakord.

Medi Bici është dakord.

Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim Këshilli i Lartë Gjyqësor, sipas propozimit të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, vendosi miratimin e projektvendimit “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për 1 pozicion të lirë” (afati i kandidimit është gjashtë javë).

Hidhet në votim nga Kryetarja e Këshillit propozimi i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës mbi projektvendimin e katërt “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për 1 pozicion të lirë”, ku afati i kandidimit është tetë javë nga dita e publikimit të këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.  
Brunilda Kadi është dakord.  
Dritan Hallunaj është dakord.  
Iilir Toska është dakord.  
Alban Toro është dakord.  
Fatmira Luli është dakord.  
Marçela Shehu është dakord.  
Erjon Muharremaj është dakord.  
Brikena Ukperaj është dakord.  
Medi Bici është dakord.  
Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim Këshilli i Lartë Gjyqësor, sipas propozimit të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, vendosi miratimin e projektvendimit “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për 1 pozicion të lirë” (afati i kandidimit është tetë javë).

Hidhet në votim nga Kryetarja e Këshillit propozimi i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës mbi projektvendimin e pestë “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për 1 pozicion të lirë”, ku afati i kandidimit është dhjetë javë nga dita e publikimit të këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.  
Brunilda Kadi është dakord.  
Dritan Hallunaj është dakord.  
Iilir Toska është dakord.  
Alban Toro është dakord.  
Fatmira Luli është dakord.  
Marçela Shehu është dakord.  
Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është dakord.

Medi Bici është dakord.

Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim Këshilli i Lartë Gjyqësor, sipas propozimit të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, vendosi miratimin e projektvendimit “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për 1 pozicion të lirë” (afati i kandidimit është dhjetë javë).

\* \* \*

(Pika 4 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË  
LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 26.02.2020)*

**Pika 5 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për hapjen e procedurës së komandimit në zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve”.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:35 dhe mbaroi në orën 15:17.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                             |                          |
|-----------------------------|--------------------------|
| <b>1. Naureda Llagami</b>   | <b>(kryetare)</b>        |
| <b>2. Maksim Qoku</b>       | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>3. Medi Bici</b>         | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>4. Fatmira Luli</b>      | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Brunilda Kadi</b>     | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>6. Dritan Hallunaj</b>   | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Ilir Toska</b>        | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>8. Alban Toro</b>        | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>9. Brikena Ukperaj</b>   | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>10. Erjon Muharremaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 5. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 6. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 7. Elisa Stamo, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 8. Anisa Brano, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 9. Gentiana Bigu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 10. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 11. Anisa Kuqi, EURALIUS.*
- 12. Tahir Lamçe, OSCE.*

**RENDI I DITËS:**

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Për hapjen e procedurës së komandimit në zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve”.

Relator i kësaj çështjeje është zoti Ilir Toska.

Merr fjalën zoti Ilir Toska i cili lexon relacionin shpjegues nr. 1431 prot., datë 25.02.2020, lidhur me përmbajtjen e projektvendimit “Për hapjen e procedurës së komandimit në zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve”.

Ndër të tjera në relacion i propozohet mbledhjes plenare:

- Hapja e procedurës së komandimit të gjyqtarit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe shpallja e kërkesës për kandidatura, nga radhët e gjyqtarëve, për komandim në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për 6 pozicione të lira si inspektor.
- Afati i paraqitjes së kërkesave për komandim të jetë dy javë nga dita e publikimit të këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

### **Diskutime/Komente/Pyetje/Propozime mbi çështjen**

Pas leximit të relacionit nga ana e zotit Toska, merr fjalën zonja **Brikena Ukperaj** e cila i drejtohet me një pyetje zotit Toska: -Cilat do të jenë dy vlerësimet e fundit “shumë mirë”? Pra duhet që Komisioni i Vlerësimi të Etikës Profesionale të kryejë vlerësimin e fundit të vitit kalendarik (si vlerësim i dytë) dhe vlerësimi i vjetër nëse do të mungojë gradimi (si vlerësim i parë). Zonja Ukperaj shton faktin që duhet t’i kërkohet Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që të kryejë procedurën e verifikimit të kandidatit dhe është e mendimit se mbase do të jenë në pamundësi të bërjes së gradimit nëse vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nuk do ketë ende formë të prerë.

Zoti **Ilir Toska** në përgjigjen e tij shprehet se do veprohet njësoj si tek ngritja në detyrë, sa kohë edhe komandimi në zyrën e ILD konsiderohet nga ligji si ngritje në detyrë.

Pas pyetjes nga zonja Ukperaj, Kryetarja e Këshillit hedh në votim propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës “Për hapjen e procedurës së komandimit në zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve” dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është dakord.

Dritan Hallunaj është dakord.

Ilir Toska është dakord.

Alban Toro është dakord.

Fatmira Luli është dakord.  
Marçela Shehu është dakord.  
Erjon Muharremaj është dakord.  
Brikena Ukperaj është dakord.  
Medi Bici është dakord.  
Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim Këshilli i Lartë Gjyqësor, vendosi: Hapjen e procedurës së komandimit në zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve, sipas propozimit të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

\* \* \*

(Pika 5 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË  
LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 26.02.2020)*

**Pika 6 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për hapjen e procedurës së komandimit në Shkollën e Magjistraturës dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve”.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:35 dhe mbaroi në orën 15:17.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                             |                          |
|-----------------------------|--------------------------|
| <b>1. Naureda Llagami</b>   | <b>(kryetare)</b>        |
| <b>2. Maksim Qoku</b>       | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>3. Medi Bici</b>         | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>4. Fatmira Luli</b>      | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Brunilda Kadi</b>     | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>6. Dritan Hallunaj</b>   | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Ilir Toska</b>        | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>8. Alban Toro</b>        | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>9. Brikena Ukperaj</b>   | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>10. Erjon Muharremaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 5. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 6. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 7. Elisa Stamo, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 8. Anisa Brano, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 9. Gentiana Bigu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 10. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 11. Anisa Kuqi, EURALIUS.*
- 12. Tahir Lamçe, OSCE.*

#### **RENDI I DITËS:**

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Për hapjen e procedurës së komandimit në Shkollën e Magjistraturës dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve”.

Relator i kësaj çështjeje është zoti Ilir Toska.

Merr fjalën zoti Ilir Toska i cili lexon relacionin shpjegues nr. 1436 prot., datë 25.02.2020, lidhur me përmbajtjen e projektvendimit të sipërcituar.

Ndër të tjera në relacion i propozohet mbledhjes plenare:

- Hapja e procedurës së ngritjes së komandimit në Shkollën e Magjistraturës dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për plotësimin e pozicionit

“Pedagog i brendshëm në Departamentin e Formimit Fillestar” në Shkollën e Magjistraturës.

- Afati i paraqitjes së kërkesave për komandim të jetë tre javë nga dita e publikimit të këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Anëtarët e Këshillit për këtë çështje të rendit të ditës nuk kanë diskutime, prandaj hidhet në votim nga Kryetarja e Këshillit propozimi i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës mbi projektvendimin “Për hapjen e procedurës së komandimit në Shkollën e Magjistraturës dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve” dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është dakord.

Dritan Hallunaj është dakord.

Illir Toska është dakord.

Alban Toro është dakord, përveç germës /b/ të pikës 8 e cila sipas zotit Toro bie në kundërshtim me nenin 264/2 e ligjit 115/2016 e cila përcakton se: “Pedagogët e brendshëm zgjidhen nga radhët e juristëve më të shquar me eksperiencë mbi 15-vjeçare si juristë, gjyqtarë, prokurorë, avokatë dhe me eksperiencë mësimdhënëse si pedagogë të brendshëm në sistemin universitar ose si pedagogë të jashtëm e të brendshëm në Shkollën e Magjistraturës, me eksperiencë mbi 10 vjet.”

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është dakord.

Medi Bici është dakord.

Naureda Llagami është dakord, përveç germës /b/ të pikës 8 (i njëjti qëndrim si zoti Toro).

Në përfundim Këshilli i Lartë Gjyqësor, vendosi: Hapjen e procedurës së komandimit në Shkollën e Magjistraturës dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga

radhët e gjyqtarëve, sipas propozimit të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

\* \* \*

(Pika 6 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË  
LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 26.02.2020)*

**Pika 7 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për rishpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Ministrinë e Drejtësisë, kohëzgjatjen, kushtet, kriteret dhe procedurën e komandimit”.

*Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.*

*Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:35 dhe mbaroi në orën 15:17.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                             |                          |
|-----------------------------|--------------------------|
| <b>1. Naureda Llagami</b>   | <b>(kryetare)</b>        |
| <b>2. Maksim Qoku</b>       | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>3. Medi Bici</b>         | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>4. Fatmira Luli</b>      | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Brunilda Kadi</b>     | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>6. Dritan Hallunaj</b>   | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Ilir Toska</b>        | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>8. Alban Toro</b>        | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>9. Brikena Ukperaj</b>   | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>10. Erjon Muharremaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 5. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 6. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 7. Elisa Stamo, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 8. Anisa Brano, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 9. Gentiana Bigu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 10. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 11. Anisa Kuqi, EURALIUS.*
- 12. Tahir Lamçe, OSCE.*

#### **RENDI I DITËS:**

7. Shqyrtimi i projektvendimit “Për rishpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Ministrinë e Drejtësisë, kohëzgjatjen, kushtet, kriteret dhe procedurën e komandimit”.

Relator i kësaj çështjeje është zoti Alban Toro.

Merr fjalën zoti Alban Toro i cili lexon pjesërisht relacionin shpjegues nr. 1432 prot., 25.02.2020, lidhur me përmbajtjen e projektvendimit “Për rishpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Ministrinë e Drejtësisë, kohëzgjatjen, kushtet, kriteret dhe procedurën e komandimit”.

Ndër të tjera në relacion i propozohet mbledhjes plenare:

- Rishpallja e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Ministrinë e Drejtësisë, kohëzgjatjen, kushtet, kriteret dhe procedurën e komandimit për:

a) Pozicionin “Drejtor i Drejtorisë së Hartimit të Legjislacionit”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit;

b) Pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Hartimit të Akteve”, në Drejtorinë e Hartimit të Legjislacionit, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit.

- Afati i paraqitjes së kërkesave për komandim është dy javë nga dita e shpalljes së këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Hidhet në votim nga Kryetarja e Këshillit propozimi i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës mbi projektvendimin “Për rishpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Ministrinë e Drejtësisë, kohëzgjatjen, kushtet, kriteret dhe procedurën e komandimit” dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është dakord.

Dritan Hallunaj është dakord.

Illir Toska është dakord.

Alban Toro është dakord.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është dakord.

Medi Bici është dakord.

Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim Këshilli i Lartë Gjyqësor, vendosi: Rishpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Ministrinë e Drejtësisë, kohëzgjatjen, kushtet, kriteret dhe procedurën e komandimit, sipas propozimit të

Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

\* \* \*

(Pika 7 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

***PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË  
LARTË GJYQËSOR***

***(Mbajtur, më 26.02.2020)***

***Pika 8 e rendit të ditës me objekt:*** Shqyrtimi i projektvendimeve:

1. “Për miratimin e vlerësimit dhe pikëzimit paraprak të kandidatëve, si dhe të listës së kandidatëve më të mirë që konkurrojnë për në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, në pozicionin e lirë, në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me vendimin nr.108, datë 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”;

a) Për vlerësimin dhe pikëzimin paraprak të kandidatit z. {...}.

2. “Për miratimin e vlerësimit dhe pikëzimit paraprak të kandidatëve, si dhe të listës së kandidatëve më të mirë që konkurrojnë për në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, në pozicionin e lirë, në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.109, datë 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”

a) Për vlerësimin dhe pikëzimin paraprak të kandidatit z. {...}.

3. “Për miratimin e vlerësimit dhe pikëzimit paraprak të kandidatëve, si dhe të listës së kandidatëve më të mirë që konkurrojnë për në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, në pozicionin e lirë, në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr.110, datë 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”;

a) Për vlerësimin dhe pikëzimin paraprak të kandidatit z. {...}.

*Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.*

*Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:35 dhe mbaroi në orën 15:17.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                             |                          |
|-----------------------------|--------------------------|
| <i>1. Naureda Llagami</i>   | <i>(kryetare)</i>        |
| <i>2. Maksim Qoku</i>       | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>3. Medi Bici</i>         | <i>(anëtar)</i>          |
| <i>4. Fatmira Luli</i>      | <i>(anëtare)</i>         |
| <i>5. Brunilda Kadi</i>     | <i>(anëtare)</i>         |
| <i>6. Dritan Hallunaj</i>   | <i>(anëtar)</i>          |
| <i>7. Ilir Toska</i>        | <i>(anëtar)</i>          |
| <i>8. Alban Toro</i>        | <i>(anëtar)</i>          |
| <i>9. Brikena Ukperaj</i>   | <i>(anëtar)</i>          |
| <i>10. Erjon Muharremaj</i> | <i>(anëtar)</i>          |
| <i>11. Marçela Shehu</i>    | <i>(anëtare)</i>         |

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 5. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 6. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 7. Elisa Stamo, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 8. Anisa Brano, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*

**9. Gentiana Bigu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**

**10. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**

**11. Anisa Kuqi, EURALIUS.**

**12. Tahir Lamçe, OSCE.**

## **RENDI I DITËS:**

8. Shqyrtimi i projektvendimeve:

1. “Për miratimin e vlerësimit dhe pikëzimit paraprak të kandidatëve, si dhe të listës së kandidatëve më të mirë që konkurrojnë për në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, në pozicionin e lirë, në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me vendimin nr.108, datë 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”;  
a) Për vlerësimin dhe pikëzimin paraprak të kandidatit z. {...}.
2. “Për miratimin e vlerësimit dhe pikëzimit paraprak të kandidatëve, si dhe të listës së kandidatëve më të mirë që konkurrojnë për në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, në pozicionin e lirë, në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.109, datë 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”  
a) Për vlerësimin dhe pikëzimin paraprak të kandidatit z. {...}.
3. “Për miratimin e vlerësimit dhe pikëzimit paraprak të kandidatëve, si dhe të listës së kandidatëve më të mirë që konkurrojnë për në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, në pozicionin e lirë, në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr.110, datë 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”;  
a) Për vlerësimin dhe pikëzimin paraprak të kandidatit z. {...}.

Relator i projektvendimit të parë është zoti Alban Toro.

Në fjalën e tij zoti Toro jep një informacion të përmbledhur (informacion i administruar në dosjen e mbledhjes plenare të datës 26.02.2020) dhe shprehet se me





Kriteri “Kualifikimi i përgjithshëm profesional” me indikatorët “Originaliteti dhe/ose impakti” (5 pikë), “Aftësitë analitike dhe hulumtuese” (5 pikë), “Saktësia, konciziteti, zhvillimi logjik, lexueshmëria, kuptueshmëria dhe gjithëpërfshirja” (5 pikë), “Interpretimi i harmonizuar” (5 pikë), “Referencat e praktikës gjyqësore” (5 pikë) – relatori ka dhënë 25 pikë;

Kriteri “Kualifikimi shtesë profesional” me nënkriteret “Kohëzgjatja e angazhimit në fushën specifike” (6 pikë), “Botime relevante dhe ndikimi i rezultateve profesionale në fushën specifike” (6 pikë), “Konsulenca dhe kontribute në hartimin e legjislacionit” (4 pikë), “Pjesëmarrja në konferenca shkencore, mësimdhënie, çmime dhe tituj” (8 pikë) – relatori ka dhënë 24 pikë;

**Kategoria “Meritat morale dhe etike”** ku përfshihet:

Kriteri “Shmangia e shfaqjes së pahijshme” - relatori ka dhënë 5 pikë;

Kriteri “Nderi dhe dinjteti” - relatori ka dhënë 5 pikë;

Kriteri “Reputacioni” - relatori ka dhënë 5 pikë;

**Kategoria “Meritat organizative dhe menaxheriale”** ku përfshihet:

Kriteri “Cilësia e platformës dhe e vizionit të paraqitur” - relatori ka dhënë 2 pikë;

Kriteri “Aftësitë vendimmarrëse” - relatori ka dhënë 4 pikë;

Kriteri “Aftësitë e komunikimit” - relatori ka dhënë 2 pikë;

Kriteri “Puna në ekip dhe puna në ambiente multidisiplinore” – relatori ka dhënë 2 pikë. **Për një total prej 87 pikësh.**

Në fund, i propozohet mbledhjes plenare:

- Miratimi i Vlerësimit dhe Pikëzimit Paraprak të kandidatit z. {...}, sipas Aktit të Vlerësimit dhe Pikëzimit Paraprak bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të këtij vendimi.
- Miratimi i listës me kandidatët më të mirë si më poshtë: z. {...}.
- Zhvillimi i intervistës me kandidatin z. {...} (data është e hapur për t’u diskutuar në mbledhje).

Fillimisht anëtarët e Këshillit, sipas rregullores, duhet të miratojnë nëse veprimet verifikuese të relatorit në fazën përgatitore dhe dokumentacioni i grumbulluar është i plotë apo jo. Rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.  
Brunilda Kadi është dakord.  
Dritan Hallunaj është dakord.  
Iilir Toska është dakord.  
Alban Toro është dakord.  
Fatmira Luli është dakord.  
Marçela Shehu është dakord.  
Erjon Muharremaj është dakord.  
Brikena Ukperaj është dakord.  
Medi Bici është dakord.  
Naureda Llagami është dakord.

Pas këtij votimi Këshilli duhet të miratojë vlerësimin dhe pikëzimin paraprak të kandidatit, por përpara hedhjes në votim merr fjalën **zonja Ukperaj**. Ajo është e mendimit që është e rëndësishme të diskutohet mënyra sesi do të pikëzohen kandidatët në konferenca ndërkombëtare që janë organizuar në Shqipëri. Kjo pasi, referuar Metodologjisë, kur është parashikuar mënyra sesi do të pikëzohen kandidatët për pjesëmarrjet e tyre në konferenca shkencore, ata janë ndarë në dy pjesë, pjesëmarrje në konferenca shkencore kombëtare dhe pjesëmarrje në konferenca shkencore ndërkombëtare në vendet e BE-së ose OECD-së, duke mos parashikuar situatën kur këto konferenca do të organizoheshin në Shqipëri.

Zonja Ukperaj është dakord me pikëzimin që ka bërë relatori pasi kandidati ka referime në konferenca ndërkombëtare të organizuara në Shqipëri dhe jashtë saj, prandaj ajo është e mendimit që duhet standardizuar interpretimi, pasi kjo rregullore mund të zbatohet edhe në rastet kur ka gjyqtarë në pozicione të komanduara ku vlerësimet nuk janë bërë nga institucioni.

Zonja Ukperaj vijon fjalën duke thënë se edhe në Metodologji, për sa i përket pjesëmarrjes në konferenca shkencore, mësimdhënie, çmime dhe tituj, pavarësisht se ku zhvillohen konferencat ndërkombëtare, kandidati duhet të marrë 2 pikë shtesë.

Merr fjalën edhe zoti **Erjon Muharremaj**, i cili shprehet se nuk ka rëndësi

vendndodhja, por përbërja e bordit shkencor të konferencës që pranon punimet. Mendimi i tij është që pikët duhet të merren edhe nëse konferenca zhvillohet në Shqipëri.

Ndërsa, në fjalën e tij, zoti **Maksim Qoku** shprehet se standardi ekziston dhe ai është ligjor, dhe mjafton që të respektohet nga Këshilli. Kur një konferencë quhet ndërkombëtare, duhet t'i plotësojë disa standarde për t'u quajtur e tillë.

Pas sqarimeve dhe interpretimeve të bëra nga disa anëtarë, Kryetarja e Këshillit propozon datën e zhvillimit të intervistimit që të jetë më 27.02.2020, ora 10:00 dhe pas kësaj hedh në votim miratimin e Vlerësimit dhe Pikëzimit Paraprak të kandidatit z. {...}, sipas Aktit të Vlerësimit dhe Pikëzimit Paraprak i cili u relatua nga zoti Toro. Rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është dakord.

Dritan Hallunaj është dakord.

Illir Toska është dakord.

Alban Toro është dakord.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është dakord.

Medi Bici është dakord (përveç pikës 4, në faqen 24 që zoti Bici do ketë një vlerësim ndryshe).

Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim Këshilli i Lartë Gjyqësor, vendosi: “Miratimin e Vlerësimit dhe Pikëzimit Paraprak të kandidatit z. {...}, sipas Aktit të Vlerësimit dhe Pikëzimit Paraprak bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të këtij vendimi. Miratimin e listës me kandidatët më të mirë si më poshtë: z. {...}. Zhvillimin e intervistës me kandidatin z. {...}, më datë 27.02.2020, ora 10:00. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të



(0 pikë), “Rezultatet e përvojës në profesion” (4 pika), “Rezultatet e trajnimeve të tjera, kualifikimeve pasuniversitare dhe gradat/titujt shkencorë” (6 pikë) dhe “Aftësitë gjuhësore” (2 pikë) - relatori ka dhënë 14 pikë;

Kriteri “Kualifikimi i përgjithshëm profesional” me indikatorët “Origjinaliteti dhe/ose impakti” (5 pikë), “Aftësitë analitike dhe hulumtuese” (5 pikë), “Saktësia, konciziteti, zhvillimi logjik, lexueshmëria, kuptueshmëria dhe gjithëpërfshirja” (5 pikë), “Interpretimi i harmonizuar” (5 pikë), “Referencat e praktikës gjyqësore” (5 pikë) – relatori ka dhënë 25 pikë;

Kriteri “Kualifikimi shtesë profesional” me nënkriteret “Kohëzgjatja e angazhimit në fushën specifike” (6 pikë), “Botime relevante dhe ndikimi i rezultateve profesionale në fushën specifike” (6 pikë), “Konsulenca dhe kontribute në hartimin e legjislacionit” (0 pikë), “Pjesëmarrja në konferenca shkencore, mësimdhënie, çmime dhe tituj” (8 pikë) – relatori ka dhënë 20 pikë;

**Kategoria “Meritat morale dhe etike”** ku përfshihet:

Kriteri “Shmangia e shfaqjes së pahijshme” - relatori ka dhënë 5 pikë;

Kriteri “Nderi dhe dinjteti” - relatori ka dhënë 5 pikë;

Kriteri “Reputacioni” - relatori ka dhënë 5 pikë;

**Kategoria “Meritat organizative dhe menaxheriale”** ku përfshihet:

Kriteri “Cilësia e platformës dhe e vizionit të paraqitur” - relatori ka dhënë 2 pikë;

Kriteri “Aftësitë vendimmarrëse” - relatori ka dhënë 4 pikë;

Kriteri “Aftësitë e komunikimit” - relatori ka dhënë 2 pikë;

Kriteri “Puna në ekip dhe puna në ambiente multidisiplinore” – relatori ka dhënë 2 pikë. **Për një total prej 84 pikësh.**

Në fund, i propozohet mbledhjes plenare:

- Miratimi i Vlerësimit dhe Pikëzimit Paraprak të kandidatit z. {...}, sipas Aktit të Vlerësimit dhe Pikëzimit Paraprak bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të këtij vendimi.

- Miratimi i listës me kandidatët më të mirë si më poshtë: z. {...}.

Zhvillimi i intervistës me kandidatin z. {...} (data është e hapur për t’u diskutuar në mbledhje).

Anëtarët e Këshillit nuk kanë diskutime për çështjen dhe ndërkohë bien dakord që ora e intervistës për këtë kandidat të jetë gjysmë ore pas intervistës së parë.

Sipas rregullores, anëtarët e Këshillit, duhet të miratojnë nëse veprimet verifikuese të relatorit në fazën përgatitore dhe dokumentacioni i grumbulluar është i plotë apo jo. Rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

(Nuk dëgjohej vota e zonjës Brunilda Kadi.)

Dritan Hallunaj është dakord.

Iilir Toska është dakord.

Alban Toro është dakord.

Fatmira Luli është dakord.

(Nuk dëgjohej vota e zonjës Marçela Shehu.)

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është dakord.

Medi Bici është dakord.

Naureda Llagami është dakord.

Pas kësaj faze, anëtarët e Këshillit duhet të miratojnë Vlerësimin dhe Pikëzimit Paraprak të kandidatit z. {...}, sipas Aktit të Vlerësimit dhe Pikëzimit Paraprak bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të këtij vendimi; Miratimi i listës me kandidatët më të mirë si më poshtë: z. {...}; Zhvillimi i intervistës me kandidatin z. {...} më datë 27.02.2020, ora 10:30. Rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është dakord.

Dritan Hallunaj është dakord.

Iilir Toska është dakord.

Alban Toro është dakord.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord.



Gjyqësor” duke caktuar si relator zotin Toska. Siç edhe u relatua më sipër, në fazën e parë është kualifikuar vetëm kandidati {...}, duke filluar kështu me mbledhjen e dokumentacionit të kërkuar për vlerësim, pikëzim dhe renditje të tij, dokumentacion i cili do të shërbente si burim vlerësimi për të gjithë procedurën.

Më tej zoti Toska relatton sa i përket vlerësimit të kritereve dhe nënkritereve për vlerësimin e kandidatit z. {...}:

**Kategoria “Meritat profesionale”** ku përfshihet:

Kriteri “Historiku arsimor dhe e shkuara profesionale” me nënkriteret “Rezultatet e studimeve të larta në drejtësi” (2 pikë), “Rezultatet e programeve të formimit fillestar” (0 pikë), “Rezultatet e përvojës në profesion” (4 pika), “Rezultatet e trajnimeve të tjera, kualifikimeve pasuniversitare dhe gradat/titujt shkencorë” (4 pikë) dhe “Aftësitë gjuhësore” (2 pikë) - relatori ka dhënë 12 pikë;

Kriteri “Kualifikimi i përgjithshëm profesional” me indikatorët “Origjinaliteti dhe/ose impakti” (5 pikë), “Aftësitë analitike dhe hulumtuese” (5 pikë), “Saktësia, konciziteti, zhvillimi logjik, lexueshmëria, kuptueshmëria dhe gjithëpërfshirja” (5 pikë), “Interpretimi i harmonizuar” (5 pikë), “Referencat e praktikës gjyqësore” (5 pikë) – relatori ka dhënë 25 pikë;

Kriteri “Kualifikimi shtesë profesional” me nënkriteret “Kohëzgjatja e angazhimit në fushën specifike” (6 pikë), “Botime relevante dhe ndikimi i rezultateve profesionale në fushën specifike” (4 pikë, duke mos pikëzuar 2 botimet jashtë vendit dhe duke u lënë në diskrecion të anëtarëve të Këshillit), “Konsulenca dhe kontribute në hartimin e legjislacionit” (4 pikë), “Pjesëmarrja në konferenca shkencore, mësimdhënie, çmime dhe tituj” (6 pikë, duke mos u marrë në konsideratë pjesëmarrja në konferenca ndërkombëtare të organizuara në Shqipëri dhe duke u lënë në diskrecion të anëtarëve të Këshillit) – relatori ka dhënë 20 pikë;

**Kategoria “Meritat morale dhe etike”** ku përfshihet:

Kriteri “Shmangia e shfaqjes së pahijshme” - relatori ka dhënë 5 pikë;

Kriteri “Nderi dhe dinjiteti” - relatori ka dhënë 5 pikë;

Kriteri “Reputacioni” - relatori ka dhënë 5 pikë;

**Kategoria “Meritat organizative dhe menaxheriale”** ku përfshihet:



Kriteri “Cilësia e platformës dhe e vizionit të paraqitur” - relatori ka dhënë 2 pikë;

Kriteri “Aftësitë vendimmarrëse” - relatori ka dhënë 4 pikë;

Kriteri “Aftësitë e komunikimit” - relatori ka dhënë 2 pikë;

Kriteri “Puna në ekip dhe puna në ambiente multidisiplinore” – relatori ka dhënë 2 pikë. **Për një total prej 82 pikësh.**

Në fund, i propozohet mbledhjes plenare:

- Miratimi i Vlerësimit dhe Pikëzimit Paraprak të kandidatit z. {...}, sipas Aktit të Vlerësimit dhe Pikëzimit Paraprak bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të këtij vendimi.

- Miratimi i listës me kandidatët më të mirë si më poshtë: z. {...}.

Zhvillimi i intervistës me kandidatin z. {...} (data është e hapur për t’u diskutuar në mbledhje).

Sipas rregullores, anëtarët e Këshillit, duhet të miratojnë nëse veprimet verifikuese të relatorit në fazën përgatitore dhe dokumentacioni i grumbulluar është i plotë apo jo. Rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është dakord.

Dritan Hallunaj është dakord.

Iilir Toska është dakord.

Alban Toro është dakord.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është dakord.

Medi Bici është dakord.

Naureda Llagami është dakord.

### **Diskutime/Komente/Pyetje/Propozime mbi çështjen**

Pas këtij votimi, merr fjalën për diskutim zonja **Brikena Ukperaj** e cila shprehet se për të mbajtur të njëjtin standard me dy kandidatët e parë propozon që “Botimet

relevante dhe ndikimi i rezultateve profesionale në fushën specifike” kandidati duhet të vlerësohet me 6 pikë dhe jo me 4 pikë sepse zoti Panda ka 2 botime në vendet e OECD-së dhe BE-së, po kështu edhe për sa i përket “Pjesëmarrjes në konferenca shkencore, mësimdhënie, çmime dhe tituj” ku zoti Panda ka marrë pjesë edhe në konferenca ndërkombëtare të organizuara jashtë shtetit, propozon që zotit Panda t’i shtohen 2 pikë të tjera dhe në tërësi të vlerësohet me 86 pikë.

Edhe zoti Toska është dakord me propozimin e zonjës Ukperaj, sa kohë u mbajt i njëjti standard edhe për dy kandidatët e tjerë.

Hidhet në votim Vlerësimi dhe Pikëzimit Paraprak i kandidatit z.{...}, sipas Aktit të Vlerësimit dhe Pikëzimit Paraprak bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të këtij vendimi (me ndryshimin që u votua më sipër pra që zoti Panda të vlerësohet me 86 pikë); Miratimi i listës me kandidatët më të mirë si më poshtë: z.{...}; Zhvillimi i intervistës me kandidatin z. {...} më datë 27.02.2020, ora 11:00. Rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është dakord.

Dritan Hallunaj është dakord.

Iilir Toska është dakord.

Alban Toro është dakord.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është dakord.

Medi Bici është dakord.

Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim Këshilli i Lartë Gjyqësor, vendosi: “Miratimin e Vlerësimit dhe Pikëzimit Paraprak të kandidatit z.{...}, sipas Aktit të Vlerësimit dhe Pikëzimit Paraprak bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të këtij vendimi. Miratimin e listës me kandidatët më të mirë si më poshtë: z. {...}. Zhvillimin e intervistës me kandidatin z. {...}, më datë

27.02.2020, ora 11:00. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.”

Mbledhja deklarohet e mbyllur.

\* \* \*

(Pika 8 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**